

PAKR.nr.42/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, av. J.S., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan PKR.nr.226/2018 datë 19.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 31.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit S.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan PKR.nr.226/2018 datë 19.12.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan PKR.nr.226/2018 datë 19.12.2018, i akuzuari S.S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale, i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 400 (katër qind) €, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij, aktgjykimi, ndërsa, i akuzuari refuzon ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues, ashtu që të njëjtit i është konfiskuar mjeti i kryerjes së veprës penale - sprej (Stop) ATTACK.

Të akuzuarin e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësja e të akuzuarit S.S., av. J.S., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me gjobë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën nuk janë njoftuar fare palët pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me aktgjykim ku është shqiptuar dënimi me burgim, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Prokuroria e Apelit përmes parashtresës PPA/1.nr.52 /2019 të datës 28 01.2019, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Me ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Mbrojtësja e të akuzuarit në ankesën e tij pretendon se dënimi është i ashpër për faktin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimin nuk u kushtoi rëndësi të duhur rrethanave lehtësuese, se i akuzuari është penduar për kryerjen e veprës penale, se gjatë tërë procedurës ka pasur sjellje korrekte, ka pranuar fajësinë, e sidomos nuk ka marrë parasysh faktin se i akuzuari është mbajtës i familjes si dhe baba i dy fëmijëve, e duke pasur parasysh rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, atëherë është dashur që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me gjobë se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Mirëpo, duke i pasur parasysh rrethanat e theksuara me të cilat është udhëhequr gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit për veprën e kryer penale në të cilat thirret në arsyetimin e aktgjykimit dhe duke i vlerësuar lidhur me kundërshtimet ankimore, kjo gjykatë i gjen të pabazuara pretendimet e ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit se dënimi është i ashpër.

Vlerësimin e rrethanave relevante për matjen e dënimit nga gjykata e shkallës së parë, se i akuzuari ka shprehur pendim të thellë për veprën e kryer penale, se i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, ndërsa, si rrethana rënduese, natyrën e veprës penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale i pranon dhe kjo gjykatë dhe konsideron se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin në përputhje me rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara dhe se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se ky dënim duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme, forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPK, për këto arsye ankesa e mbrojtëses që të akuzuari t'i shqiptohet një dënim më i butë, është refuzuar si i pabazuar, aq më parë kur në ankesë nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e pavlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, të cilat do t'i mbështeste pretendimet nga ankesa, aq më tepër kur janë përsëritur rrethanat e konstatuara dhe të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe pikërisht si rezultat i tyre edhe i ka shqiptuar dënim me gjobë, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
PAKR.nr.42/2019, më 31.01.2019

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Xhevdet Abazi
2. _____
Tonka Berishaj

Kryetari i kolegjit,
Fillim Skoro